



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za žalbe i Predstavke

ZL.Anr.356/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Zyhdi Haziri kryesues, Rafet Haxhaj dhe Faton Ademi anëtar, si dhe me pjesmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkritazi me ankesën e Ramadan Latifi, për shkak të emrit të personit të vdekur në Librin e Votimit, për Zgjedhjet Lokale të dates 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me 24.10.2017, mori këtë:

### V E N D I M

**HUDHET si e palejuar** ankesa e Ramadan Latifi, e numër ZL.Anr.356/2017 e datës 23.10.2017 me të cilën ka kërkuar që të largohet nga lista e votuesve emri i Nurije Latifi, tani më e ndjera.

### A r s y e t i m

Me datë 22.10.2017 e Ramadan Latifi, ka paraqitur ankesë me numër ZL.Anr.356/2017 me të cilën ka kërkuar që të largohet nga lista e votuesve emri i Nurije Latifi, sepse e njëjta ka ndërruar jetë më datë 29.01.2013.

Paneli, pasi shikoj paraprakisht lejueshmërinë e ankesës gjeti se:

### **Ankesa është e pa lejuar**

PZAP-i, vendos ndaj vendimeve të KQZ-së sipas nenit 122 të LZP-së, prandaj ankesa është e palejuar sepse, nuk është në juridiksionin e PZAP-it, që të ndërmerr masa përmirësuese ndaj listës së votuesve në rastet kur gjenden emra të personave të vdekur në listën e votuesve, ngase një çështje e tillë nuk parashihet me asnjë dispozitë ligjore të LZP-së, që paneli ti korrigjon listat e votuesve duke i larguar emrat e personave të vdekur nga lista.

Andaj duke u bazuar në nenin 6.4 i Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it (Rregullës nr. 02/2015) dhe nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lartpërmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

ZL.Anr. 356/2017 më datën 24.10.2017



**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.